



Prishtinë, 03 prill 2015
Kodi i ZRRE: V_716_2015

Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafin 1.6, Nenin 14 paragrafi 2 nën paragrafi 2.6 dhe 2.16, Nenet 25 dhe 43 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë nr. 03/L-185;
- Rregullën për vendosjen e Çmimeve të Gjenerimit (Rregulla për Çmimet e Gjenerimit)
- Vendimi nr V_516_2013 për Të Hyrat Maksimale Të Lejuara (MAR) që do të mbulohen nga operatori i licencuar i Termocentralit të Kosovës A dhe operatorit të licencuar të Termocentralit të Kosovës B (Gjeneratorët e Rregulluar) përmes ngarkesave për ofrimin e energjisë dhe kapacitetit;
- Aplikacionin e KEK-Gjenerimit të dorëzuar me datën 10 dhjetor 2014, në kuadër të Shqyrtimit të Nëntë të Tarifave të Energjisë Elektrike(SHTE9) me dokumentacionin relevant sqarues.

Pas shqyrtimit të shkresave dhe dokumenteve relevante, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, **në seancën e mbajtur më 03 prill 2015 nxori këtë:**

V E N D I M

- I. APROVOHEN TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE (MAR) që do të mbulohen nga operatori i licencuar i Termocentralit të Kosovës A dhe operatorit të licencuar të Termocentralit të Kosovës B (Gjeneratorët e Rregulluar) përmes ngarkesave për ofrimin e energjisë dhe kapacitetit për Furnizuesin Publik me energji elektrike për vitin relevant tarifor SHTE9.

ARSYETIM


- ✚ Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) ka pranuar nga Korporata e Energjisë Elektrike e Kosovës SH.A. (KEK) aplikacionin e KEK-Gjenerimit, për aprovim të Hyrave të Lejuara Maksimale që duhet mbledhur nga Gjeneratorët e Rregulluar përmes ngarkesave për energji dhe kapacitet.
- ✚ Në marrjen e vendimit që MAR të rimerret nga Gjeneratorët e Rregulluar, ZRRE ka marrë parasysh dokumentet si në vijim që janë lëshuar dhe publikuar në ueb faqen e saj:
 - Vlerësimi i përfundimtar – Vlerësim i detajuar i Gjenerimit të KEK-ut, i publikuar me datën 22 shkurt 2013;
 - Vlerësimi i përfundimtar-Pasqyrë, i publikuar me datën 22 shkurt 2013;





- Raport Konsultativ - Kalkulimi i Kostos së Shitjes me Shumicë të Energjisë Elektrike, i publikuar më datën 09 Mars 2015;
 - Raport Konsultativ për Llogaritjen e të Hyrave Maksimale të Lejuara dhe Ngarkesave të Gjeneratorit të Rregulluar, i publikuar me datën 09 mars 2015; dhe
 - Përgjigjet ndaj Komenteve - Shqyrtimi i nëntë i tarifave të energjisë elektrike SHTE9, i publikuar me datën 03 prill 2015.
- II. Të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulohen nga Gjeneratorët e Rregulluar "TC Kosova A dhe B" për vitin relevant tarifar SHTE9 janë **140,276,742** euro.
- III. Të Hyrat e Lejuara Maksimale për Gjeneratorët Rregulluar do t'i nënshtrohen Procesit të Përshtatjeve të Rregullta vjetore, sipas Rregullës për vendosjen e çmimeve të gjenerimit.
- IV. Të Licencuarit për Gjeneratorët e Rregulluar duhet t'i përgatisin dhe dorëzojnë për aprovim ZRRE-së ngarkesat për kapacitet dhe energji për mbulimin e të hyrave të Lejuara Maksimale të përcaktuara me këtë Vendim, brenda një afati sa më të shkurtë.
- V. Ngarkesat e propozuara nga të licencuarit duhet ndjekur parimet e vendosura në Rregullin për Çmimet e Gjenerimit dhe Metodologjia e Përcaktimit të Ngarkesave për Gjeneratorët e Rregulluar.
- VI. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe atë angleze. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhës shqipe.
- VII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të zbatohet nga operatori i licencuar i Termocentralit të Kosovës A dhe operatorit të licencuar të Termocentralit të Kosovës B duke filluar nga 1 prilli 2015 deri në shqyrtimin e rregulltar tarifar, dhe do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE:


Enver Halimi, Kryesues


Merita Kostari, Anëtare


Krenar Bujupi, Anëtar